REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
MINISTRI

Nr. 8583 prot. Tiranë, më 22.10.2026

U R D H Ë R

Nr. 224, datë 22.10.2026

PËR

EMËRIMIN E KËSHILLIT TEKNIK TË PËRHERSHËM TË DIGAVE TË MËDHA

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, të ligjit nr.9000, datë 30.01.2003, "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave", të pikës 2, të vendimit nr.406, datë 19.06.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për strukturat e Komitetit Kombëtar të Digave të Mëdha (KKDM)",

U R DH Ë R O J:

1. Këshilli Teknik i Përhershëm i Digave të Mëdha (KTPD), të ketë në përbërje anëtarët si më poshtë:

a)	Z. Dhimitër Vogli	Anëtar	Inxhinier Hidroteknik;
b)	Z. Kujtim Muço	Anëtar	Inxhinier Hidroteknik, Përfaqësues i Agjencisë së Burimeve Ujore;
c)	Znj. Miriam Ndini	Anëtar	Inxhinier Hidroteknik;
ç)	Z.Agim Lazareni	Anëtar	Inxhinier Hidroteknik;
d)	Z. Altin Kariqi	Anëtar	Inxhinier Gjeofizik.

2. Shpërblimi për pjesëmarrje në mbledhje, për çdo anëtar, bëhet sipas vendimit përkatës të Këshillit të Ministrave, pëe përcaktimin e masës së shpërblimit të anëtarëve të këshillave, bordeve ose komisioneve të përhershme të njësive të qeverisjes qendrore.

3. Për zbatimin e detyrave që rrjedhin nga ky urdhër, si dhe për funksionimin e Këshillit Teknik të Përhershëm të Digave të Mëdha, në përputhje me legjislacionin në fuqi, ngarkohen Sekretariati Kombëtar i Digave të Mëdha dhe Drejtoria e Përgjithshme Ekonomike dhe e Shërbimeve Mbështetëse në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë.

4. Urdhri nr. 260, datë 09.09.2020, i Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, "Për përbërjen e anëtarëve të Këshillit Teknik të Përhershëm të Digave të Mëdha", shfuqizohet.

5. Ngarkohen anëtarët e KTPD për zbatimin e këtij urdhri.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI

Enea Karakaçi

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
TIRANË